# Universitetet kërkojnë hise më të madhe





acebook.com/sharer/sharer.php?
ekonomiaonline.com/nacionale/shoqeri/universitetet-
PRISHTINË | 10 NËN 2016 | 08:50 | Nga Ekonomia Online

r.com/home?
www.ekonomiaonline.com/nacionale/shoqeri/universitetet-

Mënyra e financimit të institucioneve të arsimit të lartë duhet të ndryshojë.

oogle.com/share?
v.ekonomiaonline.com/nacionale/shoqeri/universitetet-

Nga universitetet publike është kërkuar që të gjenerojnë të hyra dhe të mos presin vetëm nga granti qeveritar.

Kjo çështje është ngritur nga ministri i arsimit Arsim Bajrami në Konferencën "Menaxhimi financiar i institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë", që u mbajt të mërkurën në Prishtinë.

"Secili universitet duhet të ngrejë kapacitetet e brendshme për të dizajnuar planin e zhvillimit strategjik dhe gjenerimin e të hyrave, si një mundësi e zhvillimit të një sistemi konkurrent të financimit. Jemi të vendosur të zhvillojmë procesin e profilizimit dhe krijimin e identitetit të çdo Institucioni të Arsimit të Lartë", tha ministri Bajrami duke vlerësuar rëndësinë e kësaj Konference, sa i përket gjetjes së mënyrave më të mira të financimit dhe realizimit të plotë të autonomisë financiare të Institucioneve të Arsimit të Lartë, ndërlidhjes së universiteteve me nevojat e tregut të punës dhe profilizimin e fakulteteve drejt fushave për të cilat tregu ka nevojë.

LAJME MË TË FUNDIT LE

17:06 - Lunaçek: Zgjedhja e Trump (http://www.ekonomiaonline trumpit-nuk-eshte-lajm/video/
16:58 - FMN: Të mos tejkalohet ma (http://www.ekonomiaonline tejkalohet-masa-e-mjeteve-p
16:51 - KEDS-i vazhdon me redukt (http://www.ekonomiaonline reduktime/)
16:46 - Angazhohet edhe një prok (http://www.ekonomiaonline edhe-nje-prokuror-per-hetim
16:42 - Pacolli tregon se si fuqizoh (http://www.ekonomiaonline si-fuqizohet-trepca/)
16:28 - Thaçi dhe Johnson flasin p (http://www.ekonomiaonline flasin-per-thellimin-e-bashke
16:23 - Suedia mbështet fuqishëm (http://www.ekonomiaonline fuqishem-kosoven-ne-integri
16:18 - NISMA viziton familjen Deh (http://www.ekonomiaonline familjen-dehari/)
TË GJITHA TË DITËS (HTTP://WWW.EKONOI DATE=11/10/2016)

VIDEO

Veseli i premton Lunaçekut: Kuvendi plotësojë kriteret e kërkuara
SBAShK-u ultimatum rregullohet statusi arsimtarëve të viteve
VV s'i beson Prokur Policisë së Kosovës kërkon hetim ndërkombëtar
USAID-i mbështet 3 biznese të vogla ko
Johnson i kërkon op të bashkëpunojë m pushtetin

Bajrami ka folur edhe për aplikimin e praktikave më të mira të universiteteve ndërkombëtare, sa i përket formulës së financimit, ndërlidhjen e formulës së financimit me performancën e IAL-së dhe sigurimin e të hyrave vetanake të financimit, në mënyrë që, sipas tij, Arsimi i Lartë të jetë një shtyllë e fuqishme e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe konkurrent në shtetet e BE- së.

Ministri Bajrami, po ashtu, ka ofruar mbështetjen e plotë për programet e reja, të cilat kërkohen nga studentët dhe mundësojnë ndërtimin e tyre në karrierë.

"Secili program duhet të ketë disa klauzola shtesë për të aplikuar, klauzolën e nevojës së atij programi, klauzolën e punësimit së studentëve dhe klauzolën financiare", theksoi ministri. Konferenca ku ka marrë pjesë dhe rektori i Universitetit "Hasan Prishtina", Marjan Dema si dhe përfaqësuesi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Luigji Brusa, është organizuar nga MAShT, në bashkëpunim me disa institucione vendore dhe ndërkombëtare.

Në këtë konferencë që do të jetë dyditore qëllimet kryesore janë: prezantimi i rezultateve të projektit "Ngritja e autonomisë dhe llogaridhënies financiare në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë", i financuar nga Bashkimi Evropian, përmes programit Tempus. (Gazeta Zeri)


## Kult

Besnik Tahirit po i r
kafeja e Prishtinës

Edita organizon kar
i jep fund beqarisë

Jua prezantojmë Iva
vajzën sexy të presi
Trump

Për Demin është
gjithmonë verë (Fot

Daphne Joy me foto
nga hoteli


FJALË KRYESORE:

MINISTRI BAJRAMI (HTTP://WWW.EKONOMIAONLINE.COM/TAG/MINISTRI-BAJRAMI/)

UNIVERSITETET PUBLIKE (HTTP://WWW.EKONOMIAONLINE.COM/TAG/UNIVERSITETET-PUBLIKE/)


SHPËRNDAJE

2
SHARES

(https://www.facebook.com/sharer.php?u=http://www.ekonomiaonline.com/nacionale/shoqeri/universitetet-kerkojne-hise-te-madhe/)
(https://twitter.com/share?url=http://www.ekonomiaonline.com/nacionale/shoqeri/universitetet-kerkojne-hise-te-madhe/)
(https://plus.google.com/share?url=http://www.ekonomiaonline.com/nacionale/shoqeri/universitetet-kerkojne-hise-te-madhe/)


## Të ngjashme



(http://www.ekonomiaonline.com/nacionale/shoqeri/nuk-zgjidhen-parregullsite-ne-universitete/)
**Nuk zgjidhen parregullsitë në universitete**